



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5787 Prot.

Pogradec, më 17.12.2021

VENDIM

NR. 114, DATË 16.12.2021

**PËR
MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR, PËR QËLLIME STUDIMI TË POTENCIALIT TË
ERËRAVE, ME SYNIM NDËRTIMIN E PARQEVE ELOIKË NË
BASHKINË E POGRADECIT.**

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit Nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", pikën 4 të nenit 12 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2015 "Per sektorin e energjitikes", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/ bashkive", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", neni 20 dhe neni 23 të Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr.391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 1064, datë 22.12.2010, shkronjës "j" të pikës 22 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik", *si dhe bazuar në shkresa Nr. 7754 Prot, datë 28/10/2021, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me lëndë " Kërkesë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës", si dhe shkresa Nr.112110/1 datë, 10.11.2021 drejtuar Bashkisë Pogradec nga shoqëria Wind Albania me lëndë "Kërkesë për dhënie e lejes për instalimin e shtyllës matëse për identifikimin e intesitetit të erës në teritorin në administrin të Bashkisë Pogradec, me synimin e ndërtimit të parqeve eolike", me propozim te Kryetarit te Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:*



VENDOSI:

1. Të miratojë, dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, në të cilat do të ngrihen kullat anemometrike provizore, me qëllim studimi të territorit për matjen e potencialit të erërave, për një periudhë nga 6 deri në 18 muaj dhe më pas ndërtimin e parqeve eolik në zonën e kërkuar nga kërkuesi aktual, dhe subjekteve të tjera të interesuara që mund të kërkojnë.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në respektim të pikës 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor /kullësor publik", çdo subjekt i interesuar duhet të paraqesë dokumentacionin teknik-ligjor të kërkuar pranë strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, e cila ka të drejtën për hartimin e studimit teknik-ekonomik të sipërfaqes objekt përdorimi.

3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, të nënshkruajë kontratën e qerasë, pasi të jetë hartuar raporti tekniko –ekonomik.

4. Çdo subjekt, të kryejë aktivitetin në sipërfaqet e miratuara vetëm mbas nënshkrimit të kontratës dhe dorëzimit të sipërfaqes me procesverbal dorëzimi.

5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit, Sherbimi Pyjor dhe Drejtoria Juridike, Sektori i evidentimit dhe inventarizimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

7. U shpall sot më datë 16.12.2021.

NËN KRYETARE E KESHILLIT
Manjola KAMOLLI

